

Zvicra e bën Kaçanikun me Plan rregullues urban

Ekrem Raka

KAÇANIK, 16 TETOR - Versioni para-final i Planit rregullues urban (PRRU) të zonës së parë dhe të një pjese të zonës së dytë të qytetit Kaçanik ka qenë në agjendën e debatit me qytetarë, të martën, ndërsa të pranishmit nuk kanë ngurruar edhe t'i kritikojnë disa aspekte të tij. Është thënë se PRRU-ja dhe debati i organizuar janë frut i punës së përbashkët të projektit për qeverisje lokale e decentralizim LOGOS, që financohet nga Qeveria zvicerane, dhe Komunës të Kaçanikut. "Një vit e gjysmë kemi punuar me Komunën për hartimin e këtij plani që përcaktton kahet e zhvillimit të Kaçanikut gjatë 7 vjetëve në vijim", ka theksuar Norbert Pijs, koordinator i LOGOS-it. Ai ka thënë se i mbetet Komunës ta zbatojë PRRU-në pasi të jetë miratuar nga legjislativi komunal. Ndërkaq, kryetari i Kaçanikut, Besim Ilazi, ka deklaruar se PRRU-ja është dokument me peshë për qytetin. "Vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja do të merren parasysh gjatë përpilimit të draftit final të këtij plani", u ka thënë Ilazi qytetarëve të pranishëm. Suzana Goranci, zyrtare e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e ka inkurajuar Komunën për zbatimin e planit. "Hartimi i planeve rregulluese nuk duhet të bëhet për të mbetur në sirtarë", ka theksuar ajo. Versionin para-final të planit të hartuar e ka shpalosur Bekim Troni, drejtor i Urbanizmit, i cili ka thënë se në të janë përfshirë pjesa dërmuese e propozimeve të qytetarëve, të artikuluara në debatin e mëhershëm për Planin rregullues urban



Versionin para-final të Planit të hartuar e ka shpalosur Bekim Troni, drejtor i Urbanizmit, i cili ka thënë se në të janë përfshirë pjesa dërmuese e propozimeve të qytetarëve, të artikuluara në debatin e mëhershëm për Planin rregullues urban

të artikuluara në debatin e mëhershëm për PRRU-në. Qytetarët e pranishëm e kanë vlerësuar punën e bërë për hartimin e planit, por edhe i kanë kritikuar disa aspekte të tij. "Plani është hartuar sikur Kaçaniku të ishte një qytet që shtrihet në sipërfaqe të sheshtë, ndërsa bëhet fjalë për një mjedis urban që gjendet mbi një relief kodrinor", ka theksuar Berat Luzha, zv:ministër i MPMS-së, duke folur në cilësinë e qytetarit. Në këtë kontekst, ai ka thënë se nuk duhet të ketë ndërtime

të larta përskaj rrugës kryesore "Ismail Raka". Xhemal Guri ka kërkuar përfshirjen në PRRU edhe të arkitekturës tradicionale, ndërsa një qytet tjetër ka kërkuar të caktohet lokacioni për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza. Organizatorët e debatit kanë thënë se kritikat dhe propozimet e dëgjuara do të merren parasysh gjatë hartimit të versionit final të Planit rregullues urban të zonës I dhe të një pjese të zonës II të Kaçanikut.

KOMA DITORE
16.10.2012